



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-013

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës - Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokati V.H., kundër vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 16.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet si e pa lejuar, ankesa e avokatit V.H., paraqitur kundër vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore të Prishtinës, AD/GJTHPR/09/23 datë 05.06.2023

A r s y e t i m

Në këtë Gjykatë me 14 qershor 2023 është pranuar ankesa e avokatit V.H., e paraqitur kundër vendimit AD/GJTHPR/09/23 datë 5.06.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- respektivisht Kryetares së kësaj Gjykate A.Sh.R., me të cilin është refuzuar ankesa e avokatit të lartcekur për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit N.N.. Ankesa është ushtruar për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kjo Gjykatë të aprovoj, kurse vendimi i lartcekur të ndryshohet ashtu që ndaj gjyqtarit N.N., të iniciohet procedura disiplinore, të cilën ankesë ia ka drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ushtruesja e detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të cilat i janë bashkangjitur ankesës, vlerëson se:

-Ankesa nuk është e lejuar.

Nga shkresat e çështjes del se avokati V.H., ka ushtruar ankesë ndaj gjyqtarit N.N., - gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, si autoritet kompetent për të vendosur lidhur me ankesën konform dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit Për Përgjegjësinë Disiplinore

të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve duke vendosur përkitazi me ankesën me vendimin AD/GJTHPR/09/23 datë 5.06.2023 e ka refuzuar atë si të pabazuar.

Ndaj vendimit të lartcekur në këtë gjykatë ka ushtruar ankesë avokati V.H., me propozim që ankesa të aprovohet, kurse vendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që ndaj gjyqtarit N.N., të iniciohet procedura disiplinore.

Duke pas parasysh këtë gjendje të çështjes vlerësoj se ankesa e avokatit në rastin konkret nuk është e lejuar për këto arsye:

Sipas Ligjit nr.06/L-057 “Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” respektivisht nenit 9 par.1 të këtij ligji - secili person fizik dhe juridik mund të parashtrij ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcejell tek Autoriteti Kompetent. Po ashtu, sipas këtij ligji - nenit 9 par.6 të tij autoriteti kompetent shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 par.2 (e fillon procedurën disiplinore kur vlerëson se ka bazë), përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Kurse, edhe sipas Rregullores (05/2019) nenit 7 par.1 të kësaj Rregulloreje pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare, Autoriteti Kompetent ankesën mund ta hudh, refuzon, ose të kërkojë nga Këshilli fillimin e hetimeve. Mirëpo, me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet se në rastet kur autoriteti kompetent e refuzon ankesën për inicim të procedurës disiplinore ankuesi mund të ushtroj në ankesë ndaj këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë së bashku me shkresat e bashkëngjitura vlerësoj se ankesa është e palejuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.